



**SPORT
MARKETING
PRISHTINA**

SHPALL:

KËRKESË PËR OFERTIM: MENAXHIMI I PISHINËS DHE SHËRBIMET HOTELIERE NË PISHINËN E GËRMISË NË PRISHTINË

Në bazë të Statutit të NPL“Sport Marketing” SH.A., dhe programit të punës për sezonin veror të vitit 2024 dhe 2025, NPL“Sport Marketing” shpall kërkesën për ofertim për të gjithë OE, për menaxhimin e pishinës duke përfshirë edhe inkasimin e biletave, poashtu ofrimin e shërbimeve hoteliere të cilësisë së lartë në lokacionet e planifikuara brenda hapësirave përcjellëse komerciale të pishinës për sezonën verore për të ofruar një plan kulturor, artistik dhe sportiv për vitet 2024-2025. OE janë të detyruar që planin e punës ta zbatojnë në përputhje me rregulloret e brendshme të ndërmarrjes publike Sport Marketing. Oferta më e favorshme e cila plotëson kriteret e kërkuara në thirrjen e hapur do të shpërblehet me kontratë 2 vjecare.

Historiku:

NPL“Sport Marketing”SH.A., Prishtinë. Në MTI është e regjistruar si NPL“Sport Marketing” SH.A. Çertifikata nr. 810454497, data.17.10.2000.

Misioni i NPL “Sport Marketing” SH.A. Prishtinë, është orientimi i aktiviteteve të mirëfillta drejt klientit duke pasur qytetarin, rininë, në qendër të vëmendjes. Të gjithë klientët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbime, pa diskriminim racor, religjioz, gjinor etj. Qellimi ynë kryesor është zgjërimi i shërbimeve sportive-shëndetësore dhe rekreative, ngritja e kapaciteteve intelektuale, transparencja dhe llogaridhënja, respektimi i ligjit dhe instalimin e kulturës së re menaxheriale, koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta institucionale për të ofruar shërbime cilësore në pajtim me standartet ndërkombëtare të edukimit sportivo-shëndetësor.

Përshkrimi:

1. NPL“Sport Marketing” kërkon partner biznesi për menaxhimin e pishinës së Gërmisë në tërësi dhe ofrimin e shërbimeve hoteliere dhe të aktiviteteve sportive dhe atyre kulturore gjatë **Sezonit Veror 2024 dhe 2025**. Shërbimet duhet të jenë të kualitetit të lartë. Çmimet duhet të jenë të pranueshme për qytetarët, rininë shkollore, universitare dhe për të gjithë vizitorët që frekuentojnë në pishinën e Gërmisë.
2. NPL“Sport Marketing” SH.A. ofron hapësirat e planifikuara për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të hotelierisë dhe aktiviteteve kulturoro-artistike brenda pishinës së Gërmisë, duke mundësuar edhe infrastrukturën e duhur në kyçjen e rrjetin elektrik dhe atë të ujit.

3. NPL Sportmarketing jep me kontratë 2 vjeçare për bashkëmenaxhim pishinën e Gërmisë duke përfshirë edhe shitjen dhe inkasimin e biletave, duke u bazuar në rregulloren e punës dhe çmimeve aktuale.
4. Si pjesë përbërëse e dhënies në shfrytëzim do të përfshihet poashtu amfiteatri i pishinës dhe pjesëve përcjellëse.
E rëndësishme: Plani i aktiviteteve kulturore, sportive dhe rekreacionale duhet të prezantohet paraprakisht nga fituesi i kontratës.
5. Për çdo organizim të përmasave më të mëdha të llojit si, koncerte, manifestime apo turnire sportive dhe mbrëmje kulturo-artistike, kontraktori obligohet që paraprakisht të njoftoj me shkrim menaxhmentin e NPL "Sport Marketing" SH.A. për planin e detajizuar të natyrës së manifestimit dhe mbajtjes së aktivitetit duke pasur parasysh masat organizative dhe ato të sigurisë në përpunueshmëri të plotë me ligjet në fuqi.
6. NPL "Sport Marketing" SH.A. ka përcaktuar gjithsej **6 Pika komerciale** për aktivitete të shitjes dhe shërbime të hotelierisë, ato janë:
 - Restoranti kryesor
 - Mini Restoranti "Kënd i Pizza've"
 - Pikë shitëse – tek amfiteatri aktiviteteve kulturore dhe i sportive.
 - 3 x Lokacione - pika të shitjes "**On the GO**" pije dhe produkte të paketuara ushqimore.
7. Terrenet sportive të tenisit do të mbesin në dispozicion të NPL "Sport Marketing" SH.A. mirëpo në rastin e kërkesës për organizim të ndonjë aktiviteti apo turniri të tenisit, pagesa do të bëhet në koordinim me çmimorem e përcaktuar në rregulloren e NPL "Sport Marketing" dhe me Federatën e Tenisit të Kosovës"
8. NPL "Sport Marketing" në kontratën e dhënë për bashk-menaxhim operatorit fitues do të përfshijë poashtu dhënien e të gjitha pikave reklamuese të paracaktuara për kohëzgjatjen e kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Kompania duhet të jetë e regjistruar, minimum 2 vite pranë ARBK'së dhe ta dëshmojë me çertifikat të biznesit.
- Kompania duhet të ketë së paku 2 vjet përvojë në ofrimin e shërbimeve të hotelierisë dhe marketingut duke përfshirë organizimin e aktiviteteve kulturoro-artistike (të dëshmoje me portfolio të aktiviteteve)

Ofertat e prezantuara nga OE duhet të përfshijnë:

- Planin vizuel-arkitektonik duke përfshirë përshkrimin e instalimeve për shitje dhe planin investiv për lokacionet e përcaktuara nga menaxhmenti i NPL“Sport Marketing” SH.A. në hapësirat e dedikuara për shërbimet hotelierike.
- Planin e detajuar artistiko-kulturor të detajuar të manifestimeve sportive, kulturore dhe rekreacionale.
- Investimi dhe blerja e shezlloneve dhe vendosja e çadrave, sasia 250 copë (modeli duhet të prezantohet me fotografi)
- Përshkrimin e menus dhe ushqimit prej së paku 10 produkteve ushqimore duke përfshirë edhe pijet freskuese (të përfshihet edhe çmimorja e menus)
- Planifikimi i numrit të punonjësve dhe menaxhimin e tyre,
- Përshkrimin e sistemit higjenik dhe sistemit për pastrim.
- Numrin e personelit te sigurimit

Shuma bazë e përcaktuar për ofertim për shfrytëzimin e pishinës dhe hapsirave komerciale gjatë sezonës 2024 - 2025 është **70.000.00€ për vit kalendarik, 140,000.00 Euro per 2 vite** (Nuk është e përfshirë TVSH'ja)

Pagesat parashihet të realizohen në 4 kështe të barabarta duke filluar me nënshkrimin e kontratës nga OE fitues. (Detajet do të specifikohen në kontratë)

Për të marrë pjesë në shpallje duhet deponuar mjete në vlerë prej 300 € në llogarinë e NPL “Sport Marketing”, në bankën BPB me nr. të xhirollogarisë 1300-2712-001184.61. Pas përfundimit të procesit vlera 300 € do ti mbetet kompanisë.

E rëndësishme: Pagesa e mjeteve duhet të bëhet duke u bazuar në afatet dhe termat e përcaktuara menjëherë pas lidhjes së kontratës në afat prej 5 (pesë) ditësh.

Afatet dhe termat e pageses:

Afati për dërgesën e ofertave është prej **15.05.2024 – 25.05.2024**

Ofertat e mbyllura në pliko duhet të dërgohen në zyrën kryesore të “Sportmarketingut” në Prishtinë, më së largu deri më **25.05.2024** deri në ora **12:00^h** ato oferta të cilat arrijnë pas kësaj date do të refuzohen.

Hapja e ofertave do të jetë publike në prezencë të përfaqësuesëve të kompanive me **25.05.2024** në ora **13:00h** në adresën e poshtë shënuar. Ofertën do ta fitoj kompania më e kualifikuar dhe e cila ofron kushte më cilësore dhe çmimin më të lartë se çmimi fillestar.

NPL **“SPORT MARKETING”** sh.a
Pallati i Rinise, PRISHTINË

Numri i tel. kontaktues:
+38338704779
e-maili: info@nplsportmarketing.com